



EMBASSY OF THE UNITED STATES

SKOPJE • MACEDONIA



Ambasadori Jess Baily
Fjalimi me rastin e kremtimit të ditës së pavarsisë
30 qershor, 2016

Good evening, dobra vecer, mirëmbërëma.

Capie dhe unë, si dhe i gjithë stafi i ambasadës iu dëshiroimë mirëseardhie në Ambasadën e SHBA dhe ju falënderojmë që na u bashkangjitët në kremtimin e Ditës së Pavarsisë së Amerikës.

President Ivanov, kryetar i Kuvendit Velianovski, kryeministër Dimitriev, ministra, deputetë, gjykatës, kolegë ambasadorë, zonja dhe zotërinjë, ndjehemi të nderuar që jeni këtu me ne.

Falënderime të posacme dhe mirëseardhje për sponsorët tanë të cilët mundësuan këtë mbërmje. T'i përshëndesim me duartrokitje.

Falënderime edhe për Bibën dhe Audrey-n për interpretimet e himneve kombëtare dhe për muzicentët e Substandard.

Është kënaqësi të iesh me miq dhe kolegë sonte për të kremtuar arritiet e shumta gjatë partneritetit mes vendeve tona. Nëpërmjet Korpusit të Paqës ne zgjeruam bashkëpunimin në shkolla dhe komunitete në gjithë vendin. Në KB iu bashkangjitëm 173 vendeve tiera në nënshkrimin e Marrëveshjes historike të Parisit për të luftuar ndrvshimet klimatike. Ndërsa këtu në Shkup kemi bashkëpunuar për të ndihmuar Maqedoninë të lëviz drejt antarësimit në NATO dhe UE. Kjo nënkupton ngritien e trainimeve të përbashkëta ndërmjet dy ushtirve tona. Kjo nënkupton punë për t'u marrë me çështien e krizës politike në Maqedoni, përforcimin e sundimit të ligjit dhe institucioneve demokratike, sic është theksuar në Marrëveshjen e Përzahinos. Çështiet e fundit i kanë dominuar laimet, por ne e dijmë se Maqedonia është shumë më tepër se ajo që është nëpër titullin e mediave. Maqedonia është qytetarët e saj, trashëgimia e saj dhe bukuria e saj natyrore- prej Malit Sharr deri te Liqeni i Doiranit, prej Liqenit të Ohrit dhe Prespës deri te pviët e Osogovës. Për të niohur dhe kuptuar Maqedoninë, ne duhet të largojmë shikimin nga punët e përditshme dhe të çmojmë bukurinë që na rrethon. Ndjehem i bekuar që unë prej këtu mund ta bëj këtë çdo ditë.

Këtë vit në SHBA festojmë 240-vietorin e pavarsisë dhe 100 vietorin e Shërbimit të Parave Nationale. Me 25 gusht 1916, presidenti i atëhershëm Woodrow Wilson nënshkroi aktin që krijoi Shërbimin e Parave, duke iu dhënë përgjegjësinë e kudesies për paratet nacionale dhe monumentet e Amerikës. Parku i parë nacional në Amerikë, Yellowstone, u kriiua para 44 viet dhe u quait "park publik apo terren për kënaqësi në dobi të njerëzve". Në atë kohë, kjo ishte një ide progresive, bile edhe radikale- rruajtja e vendeve në gjendjen e tyre natyrore, të paprekur, për kënaqësinë e të gjithë njerëzve.

Në SHBA, Paratet Nationale përfshiin edhe vende më rëndësi kulturore dhe historike. Ato rrëfejnë për ngjarie të rëndësishme të historisë tonë – Deklarata e Pavarsisë në Hollin e Pavarsisë në Philadelphia, Lufta Civile në Gettysburg, përfshiria e ionë në Luftën e Dvhtë Botërore në Pearl Harbor. Ato vende kremtojnë trashëgiminë tonë të emigrantëve dhe diversitetin e Ellis Island. Na ndihmojnë të ballafaqohemi me gabime tragiike- migrimi i deturvar i cerokive përgjatë Shtegut të lotëve, ose burgosia e japonezëve-Amerikane në Luftën e Dvhtë Botërore. Ato poashtu tregojnë historitë e luftave tona- për të drejtat e grave në Seneca Falls, New York, për të drejta civile në

Selma. Alabama dhe tani për të dreitat e komunitetit LGBT në Stonewall Inn në New York City- që javën e kaluar presidenti Obama emëroi si vend historik.

Dekrete për Shërbimin e Parqeve Nacionale i vitit 1916 poashtu thot se parqet duhet të ruhen “të padëmtuara për kënaqësinë e gjeneratave të ardhshme.” Parku nacional është një premtim për fëmijët tanë, për fëmijët e tyre, dhe gjeneratat e ardhshme. Duke marrë përsipër ruajtjen e parqeve tona dhe historisë tonë, ne u dhurojmë dicka vërtetë të mrekullueshme gjeneratave të ardhshme. Ne ruajmë biodiversitetin për ta, duke i përkultuar për beteja dhe zgjedhjet që kemi bërë në të kaluarën. Poashtu u sigurojmë vende me bukuri magjepsëse, duke inspiruar imagjinatën dhe frymën e tyre. Të ia prezantosh fëmijut një dru, një mal apo lum është gëzim dhe privilegj për gjeneratë në gjeneratë. Capie dhe unë e mësuam këtë derisa ngjiteshim së bashku me dialin tone në Parkun Nacional të Akullnaja, ku ai për herë të parë pa një akullnajë, dhe kur bisedonim për domethënien e Luftës Civile gjatë vizitës të Gettysburg.

Parqet nacionale vërtetë janë, sic ka thënë shkrimtari dhe historiani amerikan Wallace Stegner, “ideja më e mirë që Amerika ka pasur ndonjëherë. Absolutisht Amerikane, absolutisht demokratike, ato na paraqesin në dritën më të mirë.” Sic mund ta dini, Amerikanët shpesh nuk pajtohen për çështje të interes publik. Dhe nëse i ndiqni zgjedhjet e fundit në Amerikë, mund të thuhet se ky konstatim është me rezervë. Mirëpo, parqet nacionale janë temë për të cilën pajtohemi, pasi që parqet tona vërtetë u takojnë të gjithë Amerikanëve dhe përfaqësojnë historinë, trashëgiminë dhe kulturën e përbashkët. Edhe pse nierëzitet mund t’i debatoinë këto çështje, unë asnjëherë nuk kam takuar ndonjë që beson se ne si komb do të kishim qenë më mirë pa parqet tona.

Abraham Lincoln ka thënë se “mënyra më e mirë për të parashikuar ardhmërinë është ta krijoish atë.” Derisa po ballafaqohemi me konfliktet dhe sfidat e të sotmes, le t’i zgjidhim ato që gjeneratat e ardhshme t’a shikojnë të kaluarën me krenari për vendimet që kemi marrë, dhe t’i shënojnë ngjarjet në vendet ku i kemi sjellë ato.

Parqet tona nacionale janë rezultat i administrimit të mençur, edhe në vendin tim edhe këtu në Maqedoni. Kisha mundësi disa herë të vizitoi të tre parqet nacionale në Maqedoni, herën e fundit kur u ngrita në Malin Baba deri te Liqeni i Prespës. Së bashku me lokalitetet kulturore dhe historike, parqet tuaja janë dhurata nga prindët dhe gjyshërit, dhe dhuratat e juaja për fëmijët dhe nipërit tuaj. Sontë po kremtojmë edhe vendimet e mençura për të ruajtur këto lokalitete. Sontë kemi nderin me ne të jenë present edhe drejtorët dhe stafi i parqeve të Mavrovës, Pelisterit dhe Galicicës. Ato kanë siellur material për të treguar bukurinë e jashtëzakonshme dhe komplekse të parqeve tuaja nacionale. Ju lutem ndaluni te tavolinat e tyre, të cilat do të ju inspirojnë t’i vizitoni këto parqe. Poashtu këtu kemi disa nga fituesit e një konkursi online për disenjimin e posterëve të parqeve të Maqedonisë. Mund t’i shihni punimet e tyre të ekspozuara atje.

Tani ju ftoj të më bashkangjiteni të ngrejmë doli për 240 vjetorin e pavarësisë së SHBA dhe vendimeve të mençura që i kanë siellë gjeneratat tona të më hershme për të krijuar parqet tona nacionale. Me fjalët e presidentit Theodore Roosevelt, kampion në mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës, të ngrejmë doli për “vlerat e bukurisë natyrore si pasuri shtetërore.”

Urime Ditën e Pavarësisë dhe shpresojë se do të kënaqeni me fishekziarret që do të fillojnë posa të bëhet natë, gjithashtu me muzikën e Nina Janevës dhe 2EXIT! Faleminderit!